



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1769/1 Prot.

Tiranë, më 28.12.2021

V E N D I M

Nr. 254, Datë 28.12.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 108, datë 10.06.2021, të paraqitur nga G.Zh, kundër: Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjes politike¹” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 4193/13, datë 14.09.2020, të Departamentit të Administratës Publike (DAP-it), me lëndë “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, është transferuar nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, në pozicionin Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Pavarësisht emërimit të DAP-it, me shkresën nr. 1993, datë 26.10.2020, Urdhër i Brendshëm nr. 4, datë 26.10.2020 “Për komandim të brendshëm të përkohshëm të punonjësit”, të Drejtorit Rajonal të A.R.M Fier/Vlorë/Gjirokastrë, A.V, është komanduar në kryerjen e detyrës si protokollist, detyrë të cilën e ka pranuar dhe vazhdon të jetë i komanduar. Në datë 11.02.2021, personi i deleguar për organizimin e fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet parlamentare

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 17438, datë 06.09.2016, G.Zh është anëtar i subjektit politik: Lëvizja Socialiste për Integrim.

të vitit 2021 në Njësinë Administrative Picar, Bashkia Gjirokastrë, (në të cilën banon ankuesi) A.H, nga numri i tij i telefonit (068.....821) i ka kërkuar me sms, numrin e telefonit të Drejtorit të A.R.M Fier/Vlorë/Gjirokastrë (bashkëlidhur korrespondenca). Po në të njëjtën datë, Drejtori i A.R.M Fier, A.V e ka thirrur në zyrën e tij dhe e ka pyetur për qendrën e votimit. Pasi i ka kthyer përgjigje se voton në Njësinë Administrative Picar, fshati Kolonjë, i ka kërkuar që të angazhohet politikisht në fushatën elektorale në Gjirokastrë, në mbështetje të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Duke qenë nëpunës civil, i është përgjigjur se statusi i nëpunësit ia ndalon të angazhohet dhe të shfaqë bindjet politike publikisht në fushatë elektorale, për më tepër që është anëtar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Pas kësaj bisede, drejtori i ka bërë presione të vazhdueshme duke i sjellë pengesa në punë, duke i shkaktuar shqetësime psikologjike e shëndetësore dhe ndërprerje të pagës pa të drejtë. Në datë 10.03.2021, pa asnjë arsye, me shkresën nr. 10120, datë 10.03.2021 me lëndë “Tërheqje vëmendje”, drejtori i bën me dije se i tërhiqet vëmendja për shkeljen e rregullave të etikës, shkresë të cilën e ka kundërshtuar në datë 12.03.2021, por nuk ka marrë përgjigje. Ankuesi informon se nuk ka pasur asnjë vërejtje apo vlerësim pune negativ gjatë marrëdhënieve të punës. Me shkresën nr. 1353, datë 06.04.2021, ankuesi ka kërkuar lejen vjetore, pa dhënë arsyet e kërkesës së lejes. Punëdhënësi pa asnjë argument ligjor, i ka kthyer përgjigje të refuzimit të kërkesës për leje vjetore. Ankuesi me shkresën nr. 1518, datë 19.04.2021 ka kërkuar sërish leje vjetore për arsye shëndetësore të nënës së tij, e cila duhej të kryente ndërhyrje kirurgjikale në sy, pranë Spitalit Gjirokastrë dhe ankuesi si person i vetëm në familje duhet ta shoqëronte. Përsëri drejtori pa asnjë motiv dhe pa argument, i ka refuzuar sërish lejen e kërkuar. Me shkresën nr. 1554, datë 21.04.2021, ankuesi ka kërkuar leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore dhe familjare, por ka marrë përgjigje se i refuzohet leja, pa i dhënë asnjë argument ligjor. Në kushte të vështira psikologjike dhe stresi, i shqetësuar nga vështirësitë e shkaktuara nga drejtori A.V, në datë 23.04.2021 është paraqitur pranë urgjencës së Spitalit Gjirokastrë ku ka marrë përsëri trajtim mjekësor. Me e-mailin datë 05.05.2021, drejtuar A.V, ankuesi ka njoftuar se “për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitej në punë dhe pas përfundimit të vizitave mjekësore do të paraqiste raportin pranë financës së institucionit”. Ditën e paraqitjes në punë, ka dorëzuar raportin (Qendra Shëndetësore Picar, nr. 623, Seria A/19, nr. 005930, datë 17.05.2021, për 14 ditë pushim, nga data 05.05.2021 deri në datë 19.05.2021), Shefit të Sektorit të Financës, i cili ka shkruar “mora dijeni”. Edhe pse ka njoftuar me e-mail për mungesën e tij, Drejtori me shkresën nr. 1703, datë 07.05.2021, ka urdhëruar heqjen e pagës për tre ditë nga data 05.05.2021 deri në datë 07.05.2021. Ankuesi informon se drejtori i institucionit ka kërkuar verifikimin e raportit të lëshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrë. Në datë 26.05.2021 ka vënë verbalisht në dijeni A.V, se për shkak të thirrjes për gjyq nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë për një çështje civile, e ka të pamundur prezencën në punë në datë 27.05.2021. Në datë 27 (ditën e gjyqit) ora 08:57, ka njoftuar sërish me e-mail, drejtorin. Po atë ditë, nga zyra e protokollit, P.V, i ka kthyer përgjigje se kërkesa nuk merret parasysh nëse nuk sjell një dokument justifikues që e parashikon ligji. Në datë 28.05.2021, ankuesi ka dorëzuar në zyrën e protokollit procesverbalin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për seancën e datës 27.05.2021, me numrin e çështjes 21282-00173-20-2021, me anë të së cilit vërtetohet mungesa në punë në datën 27.05.2021. P.V, me

detyrë specialiste e zyrës së arkiv-protokollit pranë A.R.M Fier, i kthen përgjigje ankuesit, me e-mail-in datë 28.05.2021, se dokumenti i paraqitur është çështje personale dhe nuk mund të pranohet si dokument justifikues. Drejtori i institucionit me shkresën nr. 1936, datë 27.05.2021 ka urdhëruar ndërprerjen e ditës së punës. Në datë 01.06.2021, drejtori ka nxjerrë sërish Urdhër të Brendshëm, “Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës” për datat 01.04.2021, 02.04.2021 dhe 23.04.2021, pavarësisht se në datë 1 dhe 2 prill 2021 ka qenë me raport mjekësor dhe është paguar për raportin, drejtori ka urdhëruar pasqyrimin e prerjes së ditëve të punës së muajit prill, në pagën e muajit qershor. Lidhur me mungesën e datës 23.04.2021, ankuesi ka njoftuar drejtorin me e-mail-in e të njëjtës datë “se për arsye shëndetësore në familje nuk mund të paraqitej në punë”, pasi nëna e tij në moshën 82 vjeçare, shfaq problem shëndetësor dhe ai është i vetmi person në familje i cili mund të kujdeset për të. Por dhe pas njoftimit të kësaj date, në kthimin e përgjigjes P.V jashtë kompetencave të saj, e njofton se duhet të sjellë raport brenda orës 14:00 dhe se nuk pranohet asnjë lloj justifikimi tjetër, në të kundërt, do të nisët procedurë disiplinore ndaj tij. Pas kësaj përgjigje diskriminuese dhe i ngarkuar psikologjikisht nga situata, është paraqitur për ndihmë mjekësore pranë Urgjencës së Spitalit Gjirokastër, me dokumentin nr. 3715, datë 23.04.2021. Duke njoftuar sërish me e-mail, P.V dhe drejtorin, se e ka të pamundur të marrë raport për të justifikuar mungesën në punë, pasi ka qenë në shoqërim të nënës. Ankuesi deklaroi se është lehtësisht e faktuar se të gjitha veprimet e A.V në cilësinë e Drejtorit të A.R.M Fier/Vlorë/Gjirokastër, kanë ndodhur në periudhën para, gjatë dhe pas fushatës elektorale të vitit 2021. Për këtë arsye, ka bindjen se kanë pasur shkak bindjet politike për shkak të refuzimit të tij për t’u angazhuar në fushatën elektorale”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 108, datë 10.06.2021, të bërë nga G.Zh, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 887/1, datë 21.06.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë për ankesën e bërë nga G.Zh si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të dosjes personale dhe të vlerësimit të punës për vitet 2019-2020 të G.Zh.
 - Kopje të plotë të procedurës, fakteve dhe provave për tërheqjen e vëmendjes së ankuesit për shkeljen e rregullave të etikës dhe të përgjigjes së dhënë kundërshtimit të tij.
 - Kopje të Rregullores së Brendshme dhe Kodit/Rregullores të Etikës së institucionit.
 - Informacion nëse për punonjës të tjerë është tërhequr vëmendja për shkelje të rregullave të etikës gjatë periudhës së vitit 2020 deri në datë 01.03.2021 (kopje të shkresave).
 - Informacion nëse për punonjës të tjerë është refuzuar dhënia e lejes vjetore në mënyrë të përsëritur nga data 01.09.2020 deri në datë 01.03.2021 (kopje të shkresave).
 - Informacion nëse për punonjës të tjerë është refuzuar dhënia e lejes pa të drejtë page nga data 01.09.2020 deri në datë 01.03.2021 (kopje të shkresave).
 - Kopje të listë prezencës së punonjësve të institucionit, për muajt mars-qershor 2021.
 - Informacion nëse punonjës të tjerë të institucionit nuk janë paguar për ditët që kanë qenë me raport mjekësor, gjatë periudhës nga data 01.09.2020 deri në datë 01.05.2021 (kopje të shkresave).

- Informacion nëse është kërkuar verifikimi i raportit mjekësor për ndonjë punonjës të institucionit, gjatë periudhës nga data 01.09.2020 deri në datë 01.05.2021 (kopje të shkresave).

Me e-mail-in datë 05.07.2021, subjekti ankues, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Pas dërgimit të shkresës së Komisionerit nr. 887, datë 21.06.2021 me lëndë: “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, nga A.V, si drejtues i institucionit, kanë vazhduar sulme administrative diskriminuese dhe shkelje të përsëritura ndaj tij, si më poshtë: 1- Në datën 28.06.2021 i është kërkuar databaza për Qarqet Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Është ngarkuar dhe me detyra të tjera të cilat nuk i takojnë pasi nisur nga emërimi nga Njësia Përgjegjëse DAP, pozicioni i punës përgjigjet vetëm për Qarkun e Fierit dhe jo për qarqet e tjera pasi ato kanë specialistët e zyrave përkatëse sipas qarqeve. Në datë 29.06.2021, ka përfunduar dhe dërguar databazën e kërkuar për Qarqet Fier/Vlorë/Gjirokastrë. Në datë 29.06.2021, drejtori ka nxjerrë aktin nr. 2509, me lëndë “Njoftim për tërheqje vëmendje”, në të cilin e njofton se nuk ka përmbushur detyrat funksionale, ka refuzuar detyrën e caktuar nga eprori...duke i dhënë sërish vërejtje. 2- Në zyrë kanë munguar historikisht mjetet e punës. Zyra ka vetëm tavolina dhe karrige. Pasi kanë sjellë një laptop, nuk e kanë lënë të qetë të kryente detyrën e ngakruar duke e provokuar me fjalë dhe sjellë stres dhe shqetësime të tjera shëndetësore. Pas konstatimit të gjendjes së tij shëndetësore, drejtori ka telefonuar ambulancën e cila ka konstatuar, aritmi dhe stres. Në prezencë të A.V, mjeku i urgjencës ka kryer injeksion muskular (qetësues). 3- Me e-mailin datë 30.06.2021, ankuesi ka njoftuar A.V se nuk mund të paraqitet në punë për shkak të planifikimit të vizitës mjekësore tek mjeku kardiolog, që në datë 24.06.2021. Me e-mail-in datë 30.06.2021, drejtori pretendon se njoftimi për vizitë mjekësore është inskenim dhe ka sjellë pasoja të rënda për institucionin, por G.Zh informon se nuk është vënë kurrë në dijeni verbalisht apo zyrtarisht, në asnjë formë, se mungesat e tija të arsyetuara me raportet përkatëse, ato për probleme familjare, sociale apo juridike janë bërë ndonjëherë problem për institucionin. Në datë 30.06.2021 është njoftuar për Urdhërin e Brendshëm nr. 22, datë 30.06.2021 “Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës” për datën 30.06.2021, pasi nuk është paraqitur në punë. 4- Me shkresën nr. 2570, datë 01.07.2021, me lëndë “Njoftim për fillimin e ecuresë disiplinore” është njoftuar se duhet të jetë pjesëmarrës në fillimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj tij”.*

- Me shkresën nr. 887/2, datë 07.07.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë për pretendimet e bëra nga G.Zh me e-mail-in datë 05.07.2021.

Me shkresën nr. 2628, datë 06.07.2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“G.Zh është bërë pjesë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë me datë 21.09.2020, në pozicionin e punës si Specialist në Sektorin e Administrimit dhe Përpunimit të të Dhënave dhe vazhdon të jetë punonjës i këtij institucioni. Që në ditët e para të fillimit të punës edhe në vazhdim, punonjësi pothuajse çdo muaj ka paraqitur një numër të konsiderueshëm raportesh, gjë që ka penguar mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në sektorin ku ai është*

pjesë, si dhe në institucion. Më poshtë tabela me ditët kalendarike të raporteve dhe mungesave sipas muajve respektivë.

Muaji	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Ditë raport	Ska	Ska	16 ditë	9 ditë	Ska	Ska	17 ditë	8 ditë	14 ditë	5 ditë
Ditë mungesa							2 ditë	1 ditë	1 ditë	1 ditë

Referuar ankesës së G.Zh në lidhje me heqjen e pagës për tre ditë nga data 05.05.2021 deri në 07.05.2021, nga verifikimi pranë sektorit të financës rezulton që punonjësi është sqaruar dhe me shkresën nr. 2245, datë 15.06.2021, drejtuar atij se nga data 05-18 Maj 2021, ai ka paraqitur për këto ditë një raport mjekësor dhe si rrjedhim është paguar me raport. Për këto data nuk ka asnjë heqje dite pune. Gjatë muajit Prill 2021 duke qenë dhe një muaj dhe vit zgjedhor referuar shkresave nga Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 458, datë 05.04.2021 “Njesisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore për të gjitha institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil”, Urdhërit të Brendshëm nr. 982, datë 24.02.2021 “Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, Rregullores së Brendshme nr. 980, datë 24.02.2021 në lidhje me Grupin e Monitorimit, mbikqyrjen e sjelljes së punonjësve civil gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe referuar komunikimit të vazhdueshëm me institucionin epror, është ngritur Grupi i Monitorimit të sjelljes së punonjësve civil në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, me komision P.V, kryetare dhe anëtarë: P.T dhe A.V. Duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme nr. 980, datë 24.02.2021, në lidhje me Grupin e Monitorimit, Mbikqyrjen e sjelljes së punonjësve civil gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë, në fund të çdo dite pune specialistja e burimeve njerëzore, P.V raportonte pranë institucioneve eprorë listëprezencat dhe çdo dokument tjetër justifikues për çdo punonjës respektiv, dhe duke qenë se shënimi në listëprezencën e datës 23.04.2021 ishte vendosur RAPORT, kjo është arsyeja e kërimit brenda harkut kohor të orës 14.00, raporti nëpërmjet e-mail-it. Vetëm gjatë muajit Prill 2021, punonjësi G.Zh ka kërkuar 4 herë leje me kërkesat, datë: 09.03.2021, 06.04.2021, 19.04.2021 dhe 21.04.2021, të cilat janë refuzuar duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme (ku dhe leja e titullarit të institucionit, A.V është refuzuar me të njëjtin motivacion). Përsa i përket paqartësive që punonjësi ka shprehur lidhur me mangësinë e pagës së muajit Maj 2021 ai është sqaruar nga zyra e financës me shkresën nr. 2245, datë 15.06.2021 për çdo element të pagës. Referuar komunikimit elektronik në lidhje me datën 27.05.2021, datë në të cilën punonjësi ka kërkuar leje për të qenë prezent në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, ka marrë pjesë dhe si rrjedhojë nuk është paraqitur në punë. Në listëprezencën e kësaj date është shënuar “Mungesë” dhe si pasojë është ngritur Urdhëri nr. 1936, datë 27.05.2021 ku i është hequr dita e punës për këtë datë. Lidhur me këtë situatë nuk ka vazhdim të procedurave të mëtejshme. Punonjësi G.Zh ka një tërheqje vëmendje, referuar shkresës nr. 1120, datë 10.03.2021 për thyerje të rregullave të etikës duke diskutuar me titullarin e institucionit me tone të larta dhe aspak të përshtatshme për një nëpunës civil, lidhur me kërkesat e shumta për leje të zakonshme, e-mail-e për leje për arsye të ndryshme pa njoftuar apo planifikuar më parë, referuar dhe Kodit të Punës, neni 93 si dhe dërgimin e recetave apo rekomandimeve të njëpasnjëshme, gjë që në mënyrë të përsëritur është bërë shkak për ngecjen dhe pengimin e punës brenda sektorit ku ai punon. Një ndër e-

mail-et e shumta që G.Zh ka dërguar në adresë të titullarit të institucionit, është në lidhje me sëmundjen e nënës së tij 80 vjeçare, në të cilën fillimisht është kërkuar leje për këtë shkak dhe në momentin që punonjësit i është komunikuar që do ti jepet leja një javë në momentin e caktimit të datës së operimit të nënës së tij, ka pretenduar se kjo përgjigje i ka shkaktuar rëndesë psikologjike, duke ju drejtuar Urgjencës së Spitalit Gjirokastrë”.

Me shkresat nr. 2732, datë 14.07.2021 dhe nr. 2763, datë 16.07.2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, informoi Komisionerin se: *“Punonjësi G.Zh ka të gjithë infrastrukturën e mundshme për kryerjen në mënyrë optimale të të gjitha detyrave dhe funksioneve në pozicionin e punës së tij. Ashtu si zyrat e tjera dhe Zyra e Informacionit dhe Përpunimit të të Dhënave, e cila ka 2 punonjës, ka mjetet e domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si: një laptop, një printer, tavolina dhe karrige të mjaftueshme për kryerjen e punës. G.Zh gjatë muajit Qershor 2021, ashtu si edhe në muajt paraardhës vazhdon me raporte dhe me dërgim recetash, duke u bërë problem për mbarëvajtjen e punës në institucion, problem që i është komunikuar si verbalisht ashtu edhe në rrugë elektronike (email i dërguar dhe me datë 30.06.2021) ku i vendosen në fokus pasojat e rënda që kanë mungesat e shumta për institucionin në kundërshtim të plotë me atë që punonjësi pretendon. Në datë 30.06.2021, punonjësi është njoftuar me Urdhërin e Brendshëm nr. 22, në lidhje me ndërprerjen e ditës së punës, pasi në këtë datë punonjësi nuk është paraqitur në punë. Referuar pretendimit datë 28.06.2021 se i është ngarkuar një detyrë që nuk i takon, informojmë se detyra e ngarkuar është plotësisht brenda detyrave funksionale të punonjësit, referuar faqes nr. 92 të Rregullores së Brendshme nr. 120, datë 12.01.2021. Krijimi i bazës së të dhënave me të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme, nuk është një detyrë jashtë kompetencave të punonjësit. Përsa i përket trajnimeve, nuk është bërë asnjë kërkesë nga ana e ankuesit për nevojën e kryerjes së tyre, gjithsesi është detyrë e vetë punonjësit të aplikojë tek ASPA, në kalendarin e trajnimeve që ky institucion organizon”.*

Me e-mail-in datë 15.07.2021, subjekti ankues, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Në asnjë ditë pune që prej emërimit të tij në detyrë, nuk ka pasur infrastrukturën e nevojshme (kompjuter dhe printer), përveç se në datë 28.06.2021, datë në të cilën, A.V i ka ngarkuar detyrën e parë. Pas kësaj date, laptopin që ka sjellë në datën 28.06.2021 e ka marrë sërish në të njëjtën datë dhe vetëm në datë 12.07.2021 i kanë sjellë një laptop dhe një printer. Në këto kushte, ka punuar tabelat në letër A4. Në datë 12.07.2021, A.V e ka thirrur në zyrë së bashku me kolegën e zyrës S.S, me detyrë Specialiste e Zyrës së Informacionit, Administrimit dhe Përpunimit të të Dhënave Fier, dhe vetëm atij i ka kërkuar informacion për ecurinë e punës (azhurnimin e databazës). Ankuesi i është shprehur se “si mund të punojë një databaze në excel një punonjës kur nuk ka pasur asnjë ditë pune kompjuter dhe printer në zyrë”. Në përfundim të ditës së punës (datë 13.07.2021), është thirrur nga zyra e protokollit, e cila e ka vënë në dijeni për proces-verbalin e A.V, me nr. 2712, datë 12.07.2021, në të cilin A.V në mënyrë të pa vërtetë, shprehet ndër të tjera se zyra e informacionit ka laptop dhe printer. Po ashtu në mënyrë të pa vërtetë shprehet se ai i ka thënë se “nuk mund të bashkëpunoj me ju”, etj. Gjithashtu, ankuesi informon*

se në datë 14.07.2021, është njoftuar se ndaj tij do të mbahet seanca e Komisionit Disiplinor në datë 19.07.2021, në mjediset e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

Me e-mail-in datë 20.07.2021, subjekti ankues, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Në datë 19.07.2021, në mjediset e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është mbajtur Komisioni Disiplinor i iniciuar nga A.V, si Drejtues i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër. Në këtë komision ka paraqitur dhe depozituar me shkrim mbrojtjen e tij. Gjithashtu, lidhur me pretendimin e A.V për mungesë në punë në datat: 01 dhe 02 Mars 2021, ka vënë në dijeni se në datë 01.03.2021 ka qenë prezent në punë dhe ka firmosur në listëprezencë, ndërsa kolegja e zyrës S.T ka qenë ditë pushimi, për arsye sepse prezenca në punë është kryer me grafik për shkak të pandemisë COVID 19”.*

Me e-mail-in datë 06.08.2021, subjekti ankues, ka informuar Komisionerin se heq dorë nga pretendimi për diskriminim shkak të gjendjes familjare dhe në mes të tjerash ka shpjeguar se: *“A.V nuk ka kërkuar asnjëherë verifikimin e raporteve për asnjë punonjës të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, përveç se në rastin e tij. Madje as për punonjës që nuk janë paraqitur kurrë në punë, si rasti i punonjës A.Q. Pas datës 22.06.2021 (ditë kur në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër ka mbërritur shkresa e KMD-së) A.V ka vazhduar dhe vazhdon të nxjerrë urdhëra me prapaveprim për ndërperje të ditëve të pagës edhe pas 4 muajsh. Madje dhe për ditë pune të cilat janë të justifikuara me raporte apo për data të cilat ka qenë i thirrur nga gjykata. Në vijim datat e nxjerrjes së akteve: Akti nr. 2509, datë 29.06.2021 me lëndë “Njoftim për tërheqje vëmendje”, Akti nr. 2534, datë 30.06.2021, Urdhër i Brendshëm nr. 22, datë 30.06.2021 “Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”, Akti nr. 2570, datë 01.07.2021 me lëndë “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”, Akti nr. 2603, datë 02.07.2021 me lëndë “Tërheqje vëmendje”, Akti nr. 2611/1, datë 06.07.2021 me lëndë “Njoftim për tërheqje vëmendje”, Urdhër nr. 23, datë 16.07.2021, për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës, ku urdhërohet ndërperja e ditës së punës për datën 28.04.2021”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 108, datë 10.06.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1098/1, datë 02.09.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 09.09.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces si dhe kërkoi informacion dhe dokumentacion shtesë.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, G.Zh dhe Drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, A.V.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail-et, me KMD-në.

Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë deklaroi se nuk kishte shpjegime shtesë dhe se i qëndronte shpjegimeve të depozituara me shkresat e mëparshme.

Pala kundër të cilës ishte bërë ankesa nuk depozitoi gjatë seancës dëgjimore, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, me shkresën për njoftimin e seancës dëgjimore, dhe i'u la detyrë dërgimi i të gjithë informacionit të kërkuar.

Subjekti ankues me e-mail-et datë 21.09.2021 dhe 05.10.2021 ka dërguar shpjegime dhe dokumentacion lidhur me ndërprerjen e ditëve të punës dhe dokumentacionin shoqërues që arsyeton mungesën në punë, si dhe informacion mbi kundërshtimet e tij lidhur me Vendimi nr. 12, datë 25.08.2021 të Komisionit të Disiplinës të ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- Në mungesë të dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar me shkresën 1098/1, datë 02.09.2021 “Njoftim për seancë dëgjimore” dhe dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 1098/2, datë 26.10.2021, i është drejtuar sërish Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim të procedurës, A.R.M Fier/Vlorë/Gjirokastrë, me shkresën nr. 3854, datë 29.10.2021, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash ka informuar se: *“Në A.R.M Fier/Vlorë/Gjirokastrë, nuk ka pasur asnjë rast të dhënies së lejes pa të drejtë page dhe për asnjë rast nuk është kërkuar verifikimi i raportit mjekësor. Verifikimi i raportit për ankuesin është kërkuar nga titullari i institucionit duke marrë parasysh shpeshtësinë e paraqitjes së tyre. G.Zh nuk ka materiale në ngarkim”*.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë*

në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ rezulton se ankuesi me Urdhërin nr. 578, datë 21.02.2014, është emëruar në detyrën e Inspektorit, në Sektorin e Inspektimit të Ujërave, në Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Gjirokastër dhe që nga viti 2016 ka pasur statusin e nëpunësit civil³. Ankuesi ka kryer dhe ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), fakt ky që rezulton i provuar nga çertifikata e lëshuar nga ASPA në datën 27.01.2016.

Ankuesi me shkresën nr. 4193/13, datë 14.09.2020, të DAP është transferuar në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër. Me Urdhërin e Brendshëm nr. 4, datë 26.10.2020, të Drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, është komanduar përkohësisht në kryerjen e detyrës së protokollistit⁴.

A 1. *Lidhur me pretendimin e ankuesit për tërheqjen e vëmendjes nga ana e drejtuesit të institucionit, për shkelje të rregullave të etikës, moskryerjen e detyrave, mungesës në punë, dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër.*

Referuar kronologjisë së dhënies së njoftimeve për tërheqje vëmendje në ngarkim të ankuesit nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, rezulton se ndaj G.Zh kanë dalë shkresat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1120, datë 10.03.2021, “Njoftim për tërheqje vëmendje”, drejtuar G.Zh, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër ka tërhequr vëmendjen ankuesit, për thyerje të rregullave të etikës.
- Me shkresën nr. 1150, datë 12.03.2021, G.Zh ka kundërshtuar tërheqjen e vëmendjes, duke arsyetuar se nuk ka shkelur etikën sepse ka qenë korrekt në punë dhe ka zbatuar çdo

³ Referuar Vërtetimit datë 15.06.2017, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror i Ujërave, në të cilin vërtetohet se G.Zh është nëpunës civil i konfirmuar.

⁴ Ankuesi në parashtrimet e tij datë 10.06.2021, ka deklaruar se ka pranuar detyrën e caktuar.

urdhër të drejtorit dhe në këto kushte, tërheqja e vëmendjes pa i komunikuar arsyen, i duket arbitrare dhe e padrejtë. Nuk ka një përgjigje nga ana e drejtorit për kundërshtimin e G.Zh.

- Me shkresën nr. 2509, datë 29.06.2021, “Njoftim për tërheqje vëmendje”, drejtuar G.Zh, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër ka tërhequr vëmendjen ankuesit, për mospërbushje të detyrës funksionale, duke mos qënë i organizuar dhe duke refuzuar detyrën e caktuar nga eprori në datë 28.06.2021.
- Me shkresën nr. 2570, datë 01.07.2021 të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”, është njoftuar ankuesi për fillimin e ecurisë disiplinore, për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar sipas nenit 57, pika 4, germa “b⁵”, dhe shqyrtimi i shkeljes do bëhet në datë 06.07.2021.
- Me shkresën nr. 2603, datë 02.07.2021, “Tërheqje vëmendje”, drejtuar G.Zh, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër ka tërhequr vëmendjen ankuesit, për shkelje të rregullave të etikës.
- Me shkresën nr. 2611/1, datë 06.07.2021, “Njoftim për tërheqje vëmendje”, drejtuar G.Zh, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër ka tërhequr vëmendjen ankuesit, për mospërbushje të detyrave funksionale, duke mos qënë i organizuar dhe duke refuzuar të kthejë përgjigje për ecurinë e detyrave të caktuara nga eprori.
- Me Vendimin nr. 1, datë 06.07.2021, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, në cilësinë e eprorit direkt, pas njoftimit të bërë në datë 02.07.2021, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin civil G.Zh, për shkelje të rregullave të etikës, bazuar në nenin 57, pika 4/b të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Me shkresën datë 08.07.2021, drejtuar ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, AKM-së dhe DAP-it, G.Zh ka kundërshtuar të gjitha aktet shkrese të mësipërme të ndërmarra nga Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër. Ankuesi nuk i është drejtuar gjykatës për të ankimuar masën disiplinore, sipas parashikimit të bërë në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, i cili përcakton se vendimet e këtyre organeve disiplinore ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

Komisioneri vlerëson se masa e tërheqjes së vëmendjes për ankuesin edhe pse i është dhënë disa herë dhe është bazuar në shkeljet e parashikuara në nenin 57, pika 3/a) dhe pika 4/b), të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nuk është masë disiplinore e parashikuar as në ligjin për nëpunësin civil dhe as në rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Ajo mund të shërbejë si element i procedimit disiplinor, por nuk është masë disiplinore në veteve, pasi nuk parashikohet si e tillë. Për rrjedhojë ajo duhet konsideruar si një nulitet që nuk prodhon asnjë pasojë ligjore kundrejt ankuesit.

⁵ b) shkelja e rregullave të etikës;

Referuar informacionit dhe deklaratave të palëve, rezulton se në datë 11.02.2021, z. A.H⁶, përfaqësues për zgjedhjet i Partisë Socialiste në Gjirokastrë, ka biseduar në telefon me A.V⁷, duke i kërkuar që të lejonte G.Zh të mos paraqitej në punë, që të bënte fushatë për Partinë Socialiste. A.V ka refuzuar kërkesën e përfaqësuesit të PS duke argumentuar se G.Zh është nëpunës civil dhe e ka të ndaluar që të angazhohet në fushatë elektorale. Sipas pretendimit të ankuesit dhe deklaratës⁸ së A.V, rezulton se pas komunikimit të A.V me përfaqësuesin e PS-së, mes A.V dhe ankuesit është zhvilluar një takim. Në këtë takim ankuesi pretendon se i është kërkuar që të angazhohet në fushatën elektorale në mbështetje të Partisë Socialiste, por ai nuk ka pranuar për arsye se ishte nëpunës civil dhe ishte anëtar i LSI-së. Sipas deklaratës së A.V në seancë, ai i ka thënë ankuesit që të mos fusë miq për ta lënë të punojë në Gjirokastrë. Pas këtij takimi të zhvilluar mes palëve dhe mospranimit të angazhimit në fushatën elektorale, për G.Zh kanë filluar dhe veprimet tendencioze, të pretenduara prej tij.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se në datë 01.07.2021 ka dalë shkresa për njoftimin e G.Zh për fillimin e ecurisë disiplinore, por referuar deklaratës së ankuesit dhe verifikimit të shkresës, rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për këtë shkresë në datë 02.07.2021, kur është mbajtur procesverbali nr. 2603/1, në prani të ankuesit dhe specialistes së Burimeve Njerëzore P.V, në të cilin G.Zh është njoftuar mbi fillimin e procedurës disiplinore.

Në datë 06.07.2021 është mbajtur procesverbali nr. 2618/1, në prani të ankuesit dhe specialistes së Burimeve Njerëzore P.V, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të bëra nga G.Zh për të cilat ishte njoftuar paraprakisht në datë 02.07.2021. Në këtë procesverbal shkruhet se G.Zh nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion me shkrim për të justifikuar shkeljet e konstatuara.

Në vijim, me Vendimin nr. 1, datë 06.07.2021, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, në cilësinë e eprorit direkt, pas njoftimit të bërë në datë 02.07.2021, dhe pasi nuk kishte marrë kundërshtime me shkrim nga ankuesi, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin civil G.Zh, për shkelje të rregullave të etikës dhe e ka informuar se kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes së vendimit.

Marrëdhëniet e punës së ankuesit, si nëpunës civil, janë rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në nenin 59 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat dhe procedura për masat disiplinore. Në këtë nen përcaktohet se:

⁶ <https://aku.gov.al/aku-ne-qarqe/>, <http://keshilliqarkutgjrokastrer.gov.al/kryetari-i-keshillit-te-qarkut-gjrokastrer-z-a-h-mirepritisot-ne-zyren-e-tij-z-l.k-konsullin-e-pergjithshem-te-greqise-ne-gjrokastrer/>.

⁷ Referuar deklaratës së bërë gjatë seancës dëgjimore, min 29.00.

⁸ Referuar min 29.00.

1. *“Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a”⁹ të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil.*
7. *Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.....*

Në VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se:*

Kreu II, pika 1: *“Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkelje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor”.*

Pika 13. *Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe njofton, me shkrim, nëpunësin përkatës: a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të; b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim; c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre; ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.*

Në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”,* përcaktohen në mënyrë të detajuar detyra dhe procedura e organit disiplinor, Eprori direkt. Në këtë udhëzim përcaktohet se vendimi i këtij organi disiplinor ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

Në shqyrtim të procedurës dhe datave të masës disiplinore “Vërejtje”, rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për fillimin e procedurës disiplinore në datë 02.07.2021, dhe i ishte lënë afat për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij deri ditën e martë, datë 06.07.2021. Në këtë rast Komisioneri vlerëson se ankuesit i është lënë koha e mjaftueshme, prej jo më pak se 4 ditë, siç është parashikuar në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014, për të përgatitur mbrojtjen dhe për të paraqitur shpjegimet e tija, lidhur me shkeljen e pretenduar nga punëdhënësi.

⁹ a) vërejtje;

Në shqyrtim të parashikimit të mësipërm, vlerësohet se Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka respektuar afatin e parashikuar në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014, për të njoftuar ankuesin për datën se kur do të shqyrtohet shkëlja e pretenduar. Me shkresën datë 08.07.2021, ankuesi ka dërguar kundërshtimet e tij, lidhur me shkëljen e pretenduar, por nuk ka ndërmarrë veprime për ta kundërshtuar në gjykatë, ashtu siç parashikohet në Kreun II, pika 13 të VKM 115/2014.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është cënuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt, pasi ai ka patur të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në lidhje me arsyet e dhënies së masës disiplinore "Vërejtje".

Referuar dokumentacionit të dosjes personale të ankuesit dhe mbështetur në provat dhe informacionin e administruar nga palët në proces, rezulton se G.Zh prej rreth 7 vitesh është nëpunës civil dhe deri në datë 10.03.2021, nuk ka pasur masa disiplinore apo tërheqje vëmendje nga ana e eprorëve. Gjithashtu, referuar formularit të vlerësimit të nëpunësit civil G.Zh, të periudhës 01.07.2020 deri 31.12.2020, rezulton se ai është vlerësuar me rezultatin "Mirë"¹⁰, nga ana e drejtuesit të institucionit, A.V. Në formularin e vlerësimit të punës, ankuesi është vlerësuar mirë lidhur me, gabimet/saktësia në punën e kryer, realizimin në kohë të punës dhe kolegjaliteti i marrëdhënieve-marrëdhënia me kolegët. Në këtë formular të vlerësuar nga A.V nuk evidendohet fakti se ankuesi ka pasur vështirësi në të kuptuarit dhe zbatimin e detyrave. Ky vlerësim është evidentuar në vlerësimin e punës të 6-mujorit të parë të vitit 2021.

Referuar realizimit të detyrave të kërkuara dhe cilësisë së tyre, rezulton se ankuesi vetëm në datë 28.06.2021 ka pasur laptop për të kryer detyrën e caktuar. Referuar procesverbalit nr. 2712, datë 12.07.2021 në të cilin ankuesi ka shënuar "*.... deri me datë 12.07.2021 në zyrë nuk kam patur asnjë laptop*", rezulton se deri në datë 12.07.2021, (me përjashtim të datës 28.06.2021) G.Zh nuk ka pasur laptop për të kryer detyrat e ngarkuara nga eprori.

Mospajisja e të gjithë punonjësve me mjete elektronike (kompjuter/laptop) për të kryer detyrat e parashikuara dhe të ngarkuara nga eprori, është pranuar nga drejtuesi i institucionit, gjatë seancës dëgjimore, kur deklaroi¹¹ se: "*..ka një zyrë inspektorësh me 10 punonjës që kanë 3-4 kompjuter, zyrë me 7 punonjës që kanë 2 kompjuter dhe zyrë me 1 laptop*". Në këtë aspekt mospajisja e infrastrukturës së nevojshme nga ana e punëdhënësit, për të siguruar mjetet e duhura punonjësve për realizimin e detyrave, vlen për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm për G.Zh.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja nga eprori direkt, rezulton e marrë në përfundim të një procesi të rregullt ligjor.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se për sa i përket dhënies së masës disiplinore "Vërejtje", G.Zh nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e eprorit direkt. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

¹⁰ Mirë (2) Nëpunësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë.

¹¹ Referuar min 53.30 të seancës dëgjimore.

A 2. Lidhur me dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” nga ana e Komisionit Disiplinor të AKM-së.

Me shkresën nr. 2404, datë 22.06.2021, “Kërkesë për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ngritjen e Komisionit Disiplinor për punonjësën G.Zh, me motivacionin se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues ose raport mjekësor për mosprezencën në punë në datat: 01.03.2021, 02.03.2021 dhe 23.04.2021 dhe shkelje të përsëritura të rregullave të etikës në shërbimin civil.

Me Urdhërin nr. 116, datë 13.07.2021 të AKM-së “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecursisë disiplinore, në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë”, është urdhëruar ngritja dhe përbërja e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecursisë disiplinore ndaj punonjësës G.Zh.

Subjekti ankues me shkresën nr. 3299, datë 13.07.2021 dhe e-mail-in datë 14.07.2021, është njoftuar për ngritjen e Komisionit Disiplinor dhe se në datë 19.07.2021 do zhvillohej seanca me Komisionin Disiplinor. Në këtë shkresë ankuesi është njoftuar se do shqyrtoheshin shkeljet e mëposhtme:

1. Mungesë e pajustificuar në punë deri në 3 ditë pune për datat: 01.03.2021, 02.03.2021 dhe 23.04.2021 dhe datë 24.05.2021.
2. Shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil bazuar në gërmën “c” të pikës 3 të nenit 57 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Ankuesi ka paraqitur parashtrimet e tij përpara komisionit në datë 27.07.2021, kur është zhvilluar seanca dëgjimore. Komisioni i Disiplinës i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në përfundim të shqyrtimit të masës disiplinore dhe hetimit administrativ, me Vendimin nr. 12, datë 25.08.2021, vendosi:

1. Të japë masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” në zbatim të pikës “c” të nenit 58 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ndaj G.Zh, me detyrë Specialistit në Sektorin e Administrimit të të dhënave dhe Përpunimit të Informacionit në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, për shkeljen e konstatuar sipas arsytimit në këtë vendim;
2.
3.
4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit.

Në nenin 59 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohen kompetencat dhe procedura për masat disiplinore. Në këtë nen përcaktohet se:

2. *Masat disiplinore të parashikuara në shkronjët “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58¹² të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.*
3.
4. Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil;

Në VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, parashikohet se:

Kreu I, pika 2: “Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje: a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin; b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; ç) një përfaqësues të DAP-it; d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore”.

Në Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkëlqeve disiplinore”, përcaktohet në mënyrë të detajuar detyrat dhe procedurat e Komisionit Disiplinor. Në këtë udhëzim përcaktohet se vendimi i këtij organi disiplinor ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

Në analizë të legjislacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se Komisioni Disiplinor është ngritur dhe ka zhvilluar procesin e shqyrtimit të masës disiplinore sipas parashikimeve të sipërcituara, duke zbatuar procedurën dhe duke i dhënë mundësinë ankuesit për tu mbrojtur dhe për të dhënë shpjegimet e tija. Në përfundim, Komisioni Disiplinor pasi ka vlerësuar faktet e paraqitura nga ankuesi, ka bërë shqyrtimin e masës disiplinore dhe hetimin administrativ, lidhur me mungesat e pajustificuara dhe mospërmbushjes së detyrave funksionale, dhe ka marrë vendimin për dhënien e masës disiplinore për G.Zh, në zbatim të pikës “c” të nenit 58 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Lidhur me mospagimin e ditëve të punës, për mungesat e ankuesit në punë dhe mosjustifikimit të tyre, Komisioneri vlerëson se këto pretendime janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga ana e Komisionit Disiplinor, i cili ka marrë vendimin e sipërcituar.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja e marrë nga Komisioni Disiplinor i AKM-së, rezulton i ligjshëm në përfundim të një procesi të rregullt ligjor.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se për sa i përket dhënies së masës disiplinore nga Komisioni i Disiplinës, G.Zh nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të

¹² b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet. ç) largim nga shërbimi civil.

pa favorshëm nga ana e këtij komisioni. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

A 3. *Lidhur me pretendimin e ankuesit për mosdhënien e lejes vjetore, të kërkuar gjatë muajit prill 2021.*

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se:

Me shkresën nr. 1353, datë 06.04.2021, ankuesi ka kërkuar që të shfrytëzojë lejen e zakonshme të vitit 2021, nga data 12.04.2021 deri në datë 21.04.2021.

Me shkresën nr. 1518, datë 19.04.2021, ankuesi ka kërkuar përsëri që të shfrytëzojë lejen e zakonshme, për arsye shëndetësore të nënës së tij, nga data 21.04.2021 deri në datë 30.04.2021.

Me shkresën nr. 1554, datë 21.04.2021, ankuesi ka kërkuar leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore dhe familjare, nga data 22.04.2021 deri në datë 30.04.2021.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, me shkresat nr. 1353/1, datë 06.04.2021, nr. 1518/1, datë 19.04.2021 dhe nr. 1554, datë 21.04.2021, ka refuzuar kërkesat për leje vjetore dhe pa të drejtë page, duke mos dhënë arsye ligjore apo justifikim objektiv për refuzimin e kërkesave.

Lidhur me këtë pretendim, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, me shkresën nr. nr. 2628, datë 06.07.2021 ka informuar se: *“Vetëm gjatë muajit Prill 2021, punonjësi G.Zh ka kërkuar 4 herë leje me kërkesat, datë: 09.03.2021, 06.04.2021, 19.04.2021 dhe 21.04.2021, të cilat janë refuzuar duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme nr. 980, datë 24.02.2021, “Procesit të monitorimit, komunikimeve me institucionin epror” (ku dhe leja e titullarit të institucionit, A.V është refuzuar me të njëjtin motivacion)”*.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, deklaroi¹³ se: *“G.Zh ka ezauruar të gjithë lejen vjetore të vitit 2020 dhe në mars 2021 ka kërkuar leje vjetore për muajin prill 2021, por ligji e ndalon lejen vjetore në kohë fushate”*. Lidhur me këtë deklaratë A.V u shpreh se do dërgonte bazën ligjore të cilës i referohej.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, A.V deklaroi¹⁴ se ka qenë në dijeni të gjendjes shëndetësore të nënës së ankuesit, kur informoi se: *“Kam dijeni për gjendjen shëndetësore të nënës së ankuesit se ç’farë i ka thënë ai, për të bërë operacion syrin. ...Për nënën e tij, për sytë ka kërkuar 17 ditë leje dhe i kam thënë se kur të bësh operacion sytë e nënës më thuaj për 1 (një) ditë leje”*. Gjithashtu, A.V ka pasur dijeni për gjendjen shëndetësore të nënës së ankuesit, kur ky i fundit me e-mail-in datë 23.04.2021 ka informuar se: *“Ju njoftoj përsëri se e kam të pamundur të marr raport për të justifikuar mungesën e sotme, pasi nëna ime 82 vjeç, ka qenë e sëmurë”*.

¹³ Referuar min. 33.00.

¹⁴ Referuar min. 51.00 dhe 54.00.

Lidhur me sa më sipër, me shkresën nr. 3854, datë 29.10.2021, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, dërgoi kopje të Urdhrit të Brendshëm nr. 4, datë 24.02.2021 *“Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësit civilë gjatë procesit zgjedhor”* dhe kopje të Rregullores së Brendshme nr. 980, datë 24.02.2021, të grupit të monitorimit, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

Pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve, dhe bazës ligjore që rregullon kohën e punës dhe të pushimit në administratën shtetërore, rezulton se nuk ka të parashikuar asnjë kufizim lidhur me dhënien e lejes vjetore për nëpunësin civil, gjatë periudhës së fushatës elektorale.

Gjithashtu, lidhur me justifikimin e bërë nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër se dhe drejtorit i është refuzuar leja vjetore, rezulton se me e-mail-in e protokolluar pranë ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër me nr. 1290/1, datë 02.04.2021, AKM-ja nuk ka miratuar lejen e kërkuar nga A.V, bazuar në nenin 93, pika 3 e Kodit të Punës, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Pushimet vjetore duhet të jepen gjatë vitit të punës ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës, por asnjëherë nuk duhet të jenë më pak se një javë kalendarike pa ndërprerje”*. Pra, rezulton se mosmiratimi i lejes së A.V nga AKM-ja nuk është bërë për shkak të periudhës së fushatës zgjedhore.

Në nenin 40 të Ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, parashikohet kohëzgjatja e punës, lejet dhe pushimet. Në këtë nen përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil ka të drejtën për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagesë”*.

Në VKM-në nr. 511, datë 24.10.2002 *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”*, të ndryshuar, në Kreun II, pika 2, përcaktohet se: *“Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 javë kalendarike. Koha e kryerjes së lejes së pushimit vjetor përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, sipas kërkesës së nëpunësit civil apo të punonjësit, duke mos cënuar vijueshmërinë e punës.....”*, ndërsa në pikën 10 përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë, që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin apo prindërit. Kohëzgjatja e kësaj leje përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, me propozimin e eprorit të drejtpërdrejtë. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë”*.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se A.V ishte vënë në dijeni nga ankuesi për arsyen e kërkesës për leje vjetore me dhe pa pagesë, e cila kishte lidhje me gjendje shëndetësore të prindit të ankuesit. Pavarësisht kërkesës së detajuar të ankuesit, datë 19.04.2021, përsëri punëdhënësi pa një arsye objektive nuk ka miratuar lejen e kërkuar nga G.Zh. Legjislacioni i sipërcituar ka të përcaktuar qartë se nëpunësi civil ka të drejtë në raste të veçanta për arsye shëndetësore për prindërit, të kërkojë leje pa të drejtë page, dhe në këtë rast nuk ekziston dhe justifikimi i drejtuesit të institucionit, i cili në seancën dëgjimore deklaroi se: *“si mund të jap leje kur viti sapo ka filluar dhe nuk është bërë planifikimi për leje vjetore”*, arsye që nuk i ishte bërë e ditur ankuesit gjatë komunikimit shkresor.

Për sa më sipër, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm apo arsye objektive për mosdhënien e lejes vjetore ankuesit, konstaton se G.Zh është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

B. Shkaku i mbrojtur.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Z. G.Zh pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

B 1. Bindja politike

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesi ka depozituar në cilësi prove kopje të kartës së anëtarësisë nr. 17438, datë 06.09.2016, të lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, ku rezulton se G.Zh është anëtar i subjektit politik: Lëvizja Socialiste për Integrim dhe fotografi në të cilën rezulton se ankuesi është në shoqërinë e deputetit të LSI-së për Gjirokastrën (V.T) dhe të nënkryetarit të LSI-së (P.V).

Rezulton gjithashtu se, A.V ka qenë Kryetar i Komunës Topojë, Fier, gjatë periudhës 2011-2015 dhe më pas Administrator i kësaj njësie administrative, i propozuar si kandidat për Kryetar Komune, nga forca politike, Partia Socialiste¹⁵ dhe më pas nga Kryetari i Bashkisë Fier, A.S.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

¹⁵ Referuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve www.cec.gov.al

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkaku të pretenduar të diskriminimit, atë të *“bindjeve politike”* të kundërta me Drejtorin e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.

B 2. Gjendja shëndetësore

Nisur nga shqyrtimi i akteve dhe dokumentacionit të sjellë pranë KMD, pavarësisht se ankuesi nuk ka pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, Komisioneri gjykon se, pas vlerësimit të akteve dhe rrethanave në tërësinë e tyre, duhet të mbajë në konsideratë dhe vlerësimin e këtij shkak.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton se ankuesi që në periudhën e muajit tetor 2020 është pajisur në vijimësi me raporte mjekësore lidhur me gjendjen e tij shëndetësore.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkaku të gjendjes shëndetësore, pasi ankuesi gjatë muajit mars, prill, maj dhe qershor ka qenë disa herë me raport për paafhtësi të përkohshme në punë për diagnoza të ndryshme.

C . Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkaqet e mbrojtura “bindja politike” dhe “gjendja shëndetësore”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, përse i takon mosmiratimit të lejes vjetore.

Nga Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se kishte arsye ligjore për mosmiratimin e lejes vjetore të ankuesit.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga ligji i posaçëm nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Parimi i mosdiskriminimit, përbën një nga parimet mbi bazën e të cilit udhëhiqet administrimi i shërbimit civil, përfshirë këtu trajtimin e nëpunësit civil gjatë marrëdhënieve të punës, parashikuar nga neni 5, i ligjit nr. 152/2013 *“Për shërbimin civil”*, i ndryshuar.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të.

Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: (a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; (b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; (c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; (d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*¹⁶, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë¹⁷. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar ndër të tjera në bindjet politike të personit.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁸ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

¹⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹⁷ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

¹⁸ Ratifikuar me Ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

*Karta Sociale Europiane*¹⁹ në nenin 1, pika 2, parashikon: “ *Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...* ” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim²⁰. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.²¹

Në bazë të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së

¹⁹ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

²⁰ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

²¹ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, paragrafi 15.

dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²² gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminim.²³

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshëmrisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa*

²² Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht²⁴”.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesi është anëtar i partisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, duke provuar në këtë mënyrë bindjet dhe aktivitetin e tij politik. Ankuesi ka parashtruar se, fakti që bindjet e tij politike janë të kundërta me ato të titullarit të institucionit, ka sjellë si pasojë trajtimin e tij të padrejtë dhe të pafavorshëm duke mosprovuar se kishte arsye ligjore për mosmiratimin e lejes vjetore të ankuesit.

Gjithashtu rezultoi se ankuesi ka qenë i pajisur me raport për paaftësi të përkohshme në punë në datat si më poshtë: 28.10.2020 deri në datë 07.11.2020, 03.03.2021 deri në datë 07.03.2021, 16.03.2021 deri në datë 20.03.2021, 23.03.2021 deri në datë 05.04.2021, 14.04.2021 deri në datë 17.04.2021, 05.05.2021 deri në datë 19.05.2021, 21.06.2021 deri në datë 26.06.2021.

Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë në vijimësi të marrëdhënieve të punës ka qenë dyshues dhe i pakënaqur me raportet mjekësore të paraqitura nga ankuesi, për shkak të gjendjes shëndetësore të tij dhe këtë e ka shprehur dhe në shkresën nr. 2628, datë 06.07.2021 ku shprehet se: *“Që në ditët e para të fillimit të punës edhe në vazhdim, punonjësi pothuajse çdo muaj ka paraqitur një numër të konsiderueshëm raportesh, gjë që ka penguar mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në sektorin ku ai është pjesë, si dhe në institucion njëkohësisht”*.

Gjithashtu, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka kërkuar verifikimin e raportit mjekësor vetëm për ankuesin dhe nuk dërgoi kopje të listë prezencës së institucionit për periudhën mars-qershor 2021, për të verifikuar nëse ka pasur dhe punonjës të tjerë me raport mjekësor, për të cilët A.V të kishte mbajtur të njëjtin qëndrim.

Për më tepër, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka qenë paragjykses për gjendjen shëndetësore të ankuesit, kur me e-mail-in datë 30.06.2021 dërguar G.Zh i ka deklaruar se: *“Siç jua kemi përsëritur për të disatën herë historisë tuaj të inskenuar që parashikoni ditët se kur sëmureni në një muaj duke paraqitur ose jo raporte mjekësore.....”*.

Bazuar në dokumentacionin që disponohet nga procedura hetimore, Komisioneri vlerëson se ankuesi e mbart shkakun e bindjes politike dhe të gjendjes shëndetësore.

Komisioneri vlerëson se, Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, A.V, i ka të ekspozuara dhe të provuara aktivitetin e tij politik, pasi ka qenë i zgjedhur dhe përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe ka pasur dijeni për aktivitetin politik të ankuesit, kur gjatë seancës dëgjimore

²⁴ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

deklaroi²⁵ se: *“Në dijeninë time ai është marrë me fushatë, edhe gjatë kohës së punës, të pa verifikuara këto, dhe është marrë për subjektin që pretendon (LSI), e di shumë mirë këtë gjë”*.

Komisioneri duke vlerësuar marrëdhëniet e punës mes drejtuesit të institucionit dhe ankuesit, ngre dyshimin e arsyeshëm se veprimi i A.V, duke mosmiratuar lejen vjetore, ka qenë veprim i pajustificuar dhe i njëanshëm, në dëm të ankuesit.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruara.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë kundrejt ankuesit dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt.

Në këto kushte ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë kishte barrën e provës që të provonte ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore dhe trajtimit të pafavorshëm ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkaqet e pretenduara, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që të hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për këto motive.

Në mungesë të një justifikimi të tillë lidhur me veprimet e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë të ankuesit mbeten shkaqet e bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore.

Përsa më sipër, Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkaqet e bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore, kanë vepruar veçmas duke rënduar situatën e ankuesit.

Pra, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e nenit 3, pika 5 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *““Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas”*.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, nuk arriti të faktonte përpara Komisionerit se:

- Kishte arsye objektive dhe të justifikuar për mosmiratimin e lejes vjetore të ankuesit të kërkuar gjatë muajit prill 2021.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri krijon bindjen se G.Zh është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Duke iu referuar faktit se, ankuesi është anëtar i subjektit politik

²⁵ Referuar min 37.15.

Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore, dhe se punëdhënësi ka patur dijeni për to, si dhe faktit që ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë nuk arriti të provojë se nuk ka patur një trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e tyre kundrejt ankuesit për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore; Komisioneri gjykon se, justifikimi i punëdhënësit për trajtimin e G.Zh nuk ishte objektiv, i përligjur apo i justifikuar.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon bindjen dhe vlerëson se shtetasi G.Zh është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues, nga ana e Drejtorit të ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë, trajtim i cili ka ardhur për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore të ankuesit. Për rrjedhojë Drejtori i ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë ka shkelur nenin 3/5, nenin 5.1 dhe nenin 12.1.c të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenin 1, nenin 3/5, nenin 7, nenin 12, pika 1, germa c), , nenin 32.1, germa a), si dhe nenin 33, pikat 7.1, 10, 11 dhe 12, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shumëfishtë për shkak të bindjes politike dhe gjendjes shëndetësore të shtetasit G.Zh, nga ana e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA